



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

NJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË MËSUESIT 2024

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 9, datë 03.05.2024 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike, të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ju bëjmë me dije se duke filluar nga data 12 Gusht 2024, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) do të zhvillohet testimi i informatizuar i mësuesit (Portali i Mësuesit).

Në vijim, do të publikohet kalendari i zhvillimit të testimit të informatizuar dhe orari i pjesëmarrjes në testim, sipas profilit përkatës.

Testimi i informatizuar do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH).

Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA 30 minuta përpara orarit të publikuar.

Ditën e testimit, kandidati duhet të jetë i pajisur me:

1. letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
2. kopje të Kartës ID ose Pasaportës;

Kandidati pjesëmarrës duhet të ketë parasysh dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;
2. ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit;
3. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të testimit.

Pas publikimit të orarit të pjesëmarrjes, kandidati duhet të verifikojë të dhënat, në faqen zyrtare të QSHA, në adresën www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësish t’i drejtohet DRAP përkatës.

****Për çdo kandidat, orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë asnjë ndryshim orari përtej planifikimit të publikuar.***

Suksese!